



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.190/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik ALTERNATIVA, dega në Gjakovë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 16.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. **PRANOHET** si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, përkitazi lidhur me fushatën e zhvilluar në objekte publike ndërsa subjektit politik ALTERNATIVA, dega në Gjakovë i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3600 (*tremijë e gjashtëqind*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.
- II. **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e subjektit politik ALTERNATIVA, dega në Gjakovë, ne pjesën që i referohet thyerjes së Kodit të Mirësjelljes lidhur me zhvillimin e fushatës me fëmijë të mitur.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 11.10.2017 nga organizata BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, me të cilën pretendohet se kandidatja Mimoza Kusari-Lila për kryetare të komunës së Gjakovës nga radhët e subjektit politik ALTERNATIVA, ka shkelur LQP-në dhe Rregullat zgjedhore të KQZ-së, sepse e njëjta duke shfrytëzuar objektin e Qendrës Klinike të Mjeksis Familjare (QKMF) në Gjakovë, ka bërë fushatë zgjedhore, pra veprime këto që janë të ndaluara sipas nenit 4.1 i Rregullës zgjedhore nr.13/2013. Për më tepër ka theksuar se kandidatja në fjalë po ashtu ka zhvilluar fushatë zgjedhore me fëmijë të mitur, të cilat veprime janë të ndaluara sipas nenit 5.2 i Rregullës Zgjedhore të KQZ-së. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këto veprime kandidatja Mimoza Kusari-Lila, për Kryetare të Komunës së Gjakovës nga radhët e subjektit politik ALTERNATIVA, ka shkelur Kodin e Mirësjelljes.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur tri fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik ALTERNATIVA, të datës 12.10.2017, theksohet se kandidatja Mimoza Kusari-Lila për kryetare të komunës së Gjakovës ka qenë për vizitë në QKMF në Gjakovë, pra e njëjta ka vizituar përfaqësuesit e këtij institucioni pa e penguar procesin e rregullt të punës institucionale. Për më tepër ka theksuar, dispozita e nenit 35.1 e LZP-së, i referohet të emëruarve apo shërbyesve civil, pra personit që mbanë pozitë publike, prandaj konsiderojnë se kjo dispozitë ligjore nuk vlejnë për subjektet politike, për vizitat e realizuara, jashtë orarit të punës si është rasti konkret. Më tutje ka theksuar se, nga provat në lëndë nuk rezulton se është zhvilluar fushatë zgjedhore me fëmijë të mitur. Pas pranimit të urdhrin për përmirësim, subjekti politik ALTRNATIVA nuk kanë ndërmarrë masat përmirësuese, duke mos i larguar fotografitë e postuara nga faqja e rrjetit social Facebook dhe për ta dëshmuar në lëndë nuk rezulton se ka pasur evitim të shkeljes së supozuar, përgjigjes në ankesë nuk i kanë bashkangjitur fotografi si dëshmi.

Paneli, pasi që vlerësoj ankesën konstatoj se :

Ankesa është pjesërisht e bazuar

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Mimoza Kusari-Lila, kandidate për Kryetare të Komunës së Gjakovës, nga radhët e subjektit politik ALTERNATIVA, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes, nga fakti se, kandidatja në fjalë ka bërë fushatë në objekte publik, veprime këto të sanksionuara me dispozitën e nenit 35.1 të LZP-së, e cila përcakton: *“Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë i nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose e kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje”*

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik ALTERNATIVA, nuk merr pjesë për herë të

parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre paneli gjeti se brenda afatit të caktuar ka bërë evitimin e shkeljes. Ndërsa, masat që janë ndërmarrë për evitimin e shkeljes, nga Paneli janë vlerësuar pozitivisht dhe me ndikim në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi se dënimi i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli, ka vlerësuar si të pa bazuara pretendimet në ankesë përkitazi me shkeljen e nenit 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së, për faktin se nga provat në lëndë nuk rezulton se është zhvilluar fushatë zgjedhore me fëmijë të mitur, sepse nga fotografitë e administruara si provë nuk mund të vërtetohet në mënyrë të qartë dhe të sigurt se kemi të bëjmë me prezencë të fëmijëve nën moshën 18 vjeç, prandaj u vendos si në pjesën II të dispozitivit.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.190/2017 më datën 16.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së